



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA /
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Gjakovë-Djakovica-Gjakova
Kuvendi i Komunës - Gjakovë

01 Nr. _____ /2021

Dt. 29.07.2021

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12. të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 15 pika 1 të Rregullores 01 nr. 110/01-3560/2020 për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës, të datës 30.01.2020, në mbledhjen e mbajtur me dt.29.07.2021, pas diskutimeve lidhur më pikën e 6-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i Propozim Vendimit për ndarjen e Subvencioneve në vlerë 10.000€ Klubi Hendbollit “ Vëllaznimi“, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Propozim-Vendimi i Kryetarit të Komunës për ndarjen e subvencioneve në vlerë prej 10.000€ Klubin e Hendbollit “ Vëllaznimi“ nga Gjakova .
2. Mjetet financiare në vlerë prej 10,000€ të merren nga kategoria e subvencioneve Komunale.
3. Shuma e mjeteve financiare sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi do të jetë nga Tepricat e Subvencioneve .
4. Mjetet financiare të cekura në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve për realizimin e veprimtarisë Sportive të Klubit të Hendbollit “Vëllaznimi” në Gjakovë .
5. Obligohen Organet e Administratës Komunale për kryerjen e të gjitha procedurave në harmoni me të gjitha aktet Ligjore dhe nënligjore në fuqi, për ekzekutimin e mjeteve Financiare sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi, dhe të derdhen në xhirollogarinë e Klubit të Klubit të Hendbollit “Vëllaznimi” .
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.
7. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini .
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
 - Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
 - Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa
 - Klubit të Hendbollit “ Vëllaznimi” .
 - Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës
 - Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,

Z. Anton Shala